



DRFEJTORIA PER BUXHET DHE
FINANCA

05 Nr. _____ 2019
Dt.15.01.2019

Për/To/Za :	Kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj
CC:	
Nga/From/Od	Agron Demukaj – Drejtor për buxhet dhe financa
Përmes/Through/Preko :	DBF
Tema/Subject/Subjekat	Plani i punës se drejtorisë per vitin 2019



I nderuar kryetar


Drejtoria per buxhet dhe financa ka hartuar planin e punës per vitin buxhetor 2019. Neve si drejtori jemi te pergaditur qe me sukses te realizojmë planin tone te punës por neve si drejtori kemi mungese ne staf ne zyrën e tatimit ne prone pozita e inkasantit dhe anketuesit gjeodet si dhe per vitin 2019 sipas analizave dhe nevojave nga viti paraprak kërkojmë qe te formohet edhe pozita e zyrtarit per menagjim te kontratave i cili do te merrej me ecurinë e te gjitha shpenzimeve te cilat do te kontraktohen nga zyra e prokurimit dhe do te paguhen nga zyra e thesarit.

Drejtoria per buxhet dhe financa kërkon nga ju i nderuar qe te aprovoni te paktën te regrutohen me kontrat ne shërbim te veqante pozita e inkasantit dhe e zyrtarit per menagjim te kontratave deri ne procesin e rishikimit e mandej te shikohet me proces te rishikimit nëse eshte e mundur qe këto pozita te validohen ne proces si shërbyes civil te rregulli komunal. Per regrutimin e pozitave ne fjale neve kemi mjete financiare te mjaftueshme per pagën baze prej 300.00€ ne afatin 6 mujor.

Ju lutem e gjeni ne ankes te bashkangjitur planin e punës se drejtorisë per vitin 2019.

Sinqerisht


Agron Demukaj – DBF Komuna Deçan





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2019

DEÇAN 2019

Plani i punës për vitin 2019 i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa do të jetë në harmoni të plotë me planet e punës së Qeverisë Komunale, duke pasur parasysh respektimin e plotë të Ligjeve dhe rregulloreve që e rregullojnë punën mjaft delikate të kësaj drejtorie siq janë:

Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë ,
Ligjin mbi financa të pushtetit lokal,
Ligjin mbi vetqeverisjen lokale,
Urdhëresat Administrative si dhe
Rregulloret financiare të MF-it gjegjësisht Departamentit të Buxhetit dhe Thesarit.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa do të funksionojë gjatë vitit 2019 në dy sektore:

1. Sektori i Buxhetit dhe financave ku është e inkuadruar edhe zyra e te hyrave
2. Sektori i tatimit në pronë

PLANI SIPAS SEKTORËVE

1.SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCAVE

Në sektorin për Buxhet e Financa gjatë vitit 2019 planifikojmë këto aktivitete:

1. Përgatitja e planit për zotimin-shpenzimin e buxhetit (rrjedha e parasë) viti 2019 për të gjitha programet buxhetore.
2. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave buxhetore të vitit 2018-Pasqyrat financiare
3. Përgaditja e raportit janar-dhjetor e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore 2018
4. Bartja e mjeteve të mbetura të pashpenzuara nga viti 2018 (të hyrat vetanake) për shpenzim në viti 2019 me vendim të Asamblese Komunale
5. Raportimi i faturave të pa paguara për të gjitha programet
6. Zotimi i mjeteve të alokuara për programe dhe kategori ekonomike
7. Regjistrimi i shpenzimeve sipas modulit të aprovimit dhe blerjes/ B.K
8. Regjistrimi i të gjitha parave të imta dhe avanseve
9. Çertifikimi dhe Aprovimi i të gjitha pagesave në nivel komunal
10. Barazimi mujor i shpenzimeve në sistemin FB.
11. Rishikimi buxhetor gjashtëmujor 2019 (nëse MF e parasheh me UA)
12. Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore të mjeteve sipas dinamikës së paraparë për vitin fiskal 2019
13. Ndhmon në rregullimet e buxhetit përmes ridestinimeve dhe transfereve brenda programit buxhetor dhe programeve brenda OB
14. Përgatitja e KAB-it komunal 2020-2022 dhe planifikimi i buxhetit për vitin 2020 konform Qarkoreve buxhetore nga MF-i si dhe udhëzimeve tjera.
15. Rgjistrimi i të dhënave buxhetore në sistemin BDMS

16. Ndhmon të gjitha programet komunale në regjistrimin e të dhënave në BDMS dhe PIP sistem
17. Siguron procedura dhe formate administrative për hartimin e buxhetit 2020
18. Siguron material mbështetës për dëgjimet buxhetore për të gjithë pjesëmarrësit në proces
19. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave buxhetore, pasqyrat financiare nëntëmujori i vitit 2019
20. Hartimi i raporteve mujore dhe periodike financiare/ 2019
21. Barazimet periodike me Departamentin e Thesarit për të hyra dhe shpenzimet
22. Mbajtja dhe azhurimi i regjistrit të pasurive komunale
23. Regjistrimi në SIMFK i pasurisë më vlerë mbi 1.000€
24. Regjistrimi në E-pasuri i të gjitha aseteve nën 1000€
25. Përgatitjet dhe aktivitetet për përmbylljen e vitit fiskal buxhetor 2019
26. Paportet periodike dhe përfundimtare të buxhetit për Kuvendin Komunal , raportet periodike të realizimit të projekteve kapitale dhe dorëzimi i tyre në MF.

. Sektori i financave - Zyrta e të hyrave vetanake :

1. Përgatitjet e nevojshme teknike-organizative për punë për vitin 2018, me qëllim të kryerjes së detyrave me efikasitet, dhe arritjen e rezultateve më të mira të mundshme
2. Planifikimi i të hyrave sipas llojeve dhe programeve përbrenda komunës, harmonizimi i tyre sipas pozicioneve brenda kufijve të buxhetit të planifikuar - miratuar
3. Raportet mujore për arkëtimin e gjithë të hyrave komunale sipas llojeve dhe programeve
4. Arkëtimet ditore të të hyrave nga taksat dhe tarifat, për shërbimet e ofruara nga komuna
5. Regjistrimi ditor i të hyrave në free-balance, Sistem i MF-is, dhe nxjerrja e raporteve të nevojshme bankare që pasqyrojnë të hyrat e arkëtuara
6. Barazimet për çdo muaj me drejtorinë komunale, dhe D.eTh. në Ministrinë e Financave
7. Shpërndarja - alokimi për çdo muaj i të hyrave të realizuara sipas pozicioneve buxhetore

Përveç planeve të cekura më sipër Sektori i Buxhetit dhe Financave do të jetë në bashkëpunim permanent me MF-in, Departamentin e Buxhetit dhe Thesarit , për çdo ndryshim eventual me qëllim të ndryshimeve të granteve dhe përfitimeve të Donacioneve të ndryshme stimuluese.

2.SEKTORI I TATIMIT MBI PRONËN

1. Për vitin 2019 parashihet lëshimi i afro 7200 faturave tatimore aktive (në shumë prej 235.500,00.€) si dhe shpërndarja e tyre deri tek obliguesit tatimor në periudhën Janar-Mars marrëveshje me PTK

2. Për periudhën Prill-Maj komisioni i ankesave administrative të TP-së i cili merr vendime për ankesa të cilat bëhen nga ana e obliguesve tatimor, do të bëhen edhe ndryshime me kohë në programin e TP-së me vendimet e komisionit të ankesave.

3. Shpërndarja e vërejtjeve për pagese me leterkujtesa do të bëhet gjatë periudhës Shkurt – Korrik 2019..

6. Ri regjistrimi i objekteve dhe verifikimi i objekteve të vjetra sipas zonave nga regjistruerit me kontrat Shkurt Korrik 2019:

NË MENYRË TABELARE BARTËSIT E DETYRAVE DHE AFATET KOHORE

NR	AKTIVITETI	BARTESI I AKTIVITETIT	PLANIFIKIMI I REALIZIMIT	KOMENTE
1	Mbyllja e vitit 2018 dhe fillimi i vitit 2019, me buxhetimin programor – sipas Drejtorive	Thesari – zyra për kontabilitet	Janar 2019,	Vazhdon gjatë vitit 2019
2	Përgaditja e Pasqyrave vjetore financiare	DBF – Thesari dhe kontabiliteti	Janar 2019	30.01.2019 dita e fundit
3	Raporti vjetor mbi borgjet e mbetura të komunës për vitin 2017	Sektori buxhet e financa dhe zyrtet e arsimit dhe shëndetësis	Janar 2019	25.01.2019 dita e fundit
4	Alokimet e tre-mujorit të parë, dyte, trete dhe katertdhë ndarja e mbrendëshme në mes të programeve komunale	Sektori buxhet e financa dhe zyrtet e arsimit dhe shëndetësis	Janar –Shkurt 2019 Prill 2019 Korrik 2019 Tetor 2019	Vazhdin për secilin tremujor MF – Dep Thesari Qendror
5	. Raporti Financiar për vitin 2017	Sektori buxhet dhe financa	Mars 2019	KPF dhe Asamble
6	Shtypjen dhe shpërndarja e faturave tatimore mbi tatimin në pronë	DBF-STP Posta e Kosoves	Shkurt – Mars 2019	30.03.2019 Dita e fundit e shpërndarjes

7	Pergaditja e Raporteve Financiar tremujore TM1, TM2 dhe TM3/2019	Sektori buxhet dhe financa	Prill 2019 Korrik 2019 Tetor 2019	KPF dhe Asamble
8	Transferi i mjeteve të grumbulluara nga të hyrat vetanka mujore, nga llogarit bankare në Buxh.Kons.të Kosovë dhe alokimi i tyre	Sektori buxhet dhe financa Zyra e te hyrave	Janar – Dhjetor 2019	Vazhdon per secilin muaj veq e veq
9	Rishikimi Buxhetor – 2019 duke u bazuar në kërkesat e secilit Program buxhetor dhe kategori ekonomike	Sektori buxhet dhe financa	Qershor 2019	MF – Udhezimi administrativ per rishikim buxheti
10	Përcjellja e realizimit të Buxhetit 2018 ,duke u bazuar procedurat e rregullta të shpenzimeve dhe planifikimit të buxhetit	Sektori buxhet dhe financa	Janar Dhjetor 2019	Raporte mujore ZKF dhe ZKA
11	Pregaditja e Buxhetimit Programor për vitin 2020-2022 Për çdo program buxhetor , pas Dëgjimeve buxhetore	Sektori buxhet dhe financa ne koordinim me te gjitha drejtorite	Maj – Shtator 2019	KPF Asamble
12	Barazimet e te hyrave dhe shpenzimeve me evidencen e FREBalance	Sektori buxhet dhe financa	Janar Dhjetor 2019	ZKF / ZKA
13	Ri regjistrimi i te gjitha pronave ne territorin e komunës per qellim te tatimit ne prone	Sektori i tatimit ne prone – regjistrues me kontrat ne shërbim	Shkurt 2019 Korrik 2019	Azhurimi i databazes
14	Pune te tjera te cilat lidhen me buxhetin dhe me ministritë e linjes	DBF	Janar Dhjetor 2019	ZKA

Per fund DBF është ne gatishmëri te kontribuojë ne mbarëvajtjen dhe stabilitetin financiar te Komunës dhe rolin e saj këshill dhënës ne aspektin buxhetor.

Me respekt

Drejtori :
Agron Demukaj

